

Akti i Themelimit
Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (shpk)
Dea Georgia Ivy

Sot, me 15/05/2024, Une e nenshkruara:

(i) Ophelia Alice Elizabeth Braçe, lindur në Truro, Mbretëria e Bashkuar, më 26 dhjetor 1986, shtetase Angleze, banuese ne Shqipëri, me pasaport no. 146034687, me adrese: Njësia Administrative Nr. 2, Rruga Ali Visha, Nd. 44, hyrja 2, Tiranë.

Me vullnetin time te lire dhe ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare (Ligji i Shoqerive) kam vendosur te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **Dea Georgia Ivy** (“Shoqeria”) duke nenshkruar kete Akt Themelimi.

Neni 1

Emri dhe forma ligjore

1.1 Emri i shoqerise do te jete **Dea Georgia Ivy**, ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi “shpk”, e cili perfaqeson formen ligjore te saj.

1.2 Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne pajtim me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Neni 2

Selia dhe kohezgjatja

2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Njësia Administrative Nr. 2, Rruga Ali Visha, Nd. 44, hyrja 2, Tiranë. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjetër te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

2.2 Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

Neni 3

Objekti i veprimtarise

3.1 Objekti i veprimtarive te Shoqerise eshte: Ofrimi i shërbimeve të marketingut online. Kryerja e hulumtimeve te marketingut. Marrja e informacionit nga tregu. Analizimi i te dhenave dhe zhvillimi i strategjive te ndryshme te marketingut. Aktivitet ne fushen e marketingut ne Web. Prodhim dhe studim i shërbimeve te marketingut, te shërbimeve te komunikimit qe rrjedhin nga zhvillimi i teknologjive pa kufizime territoriale. Aktivitet ne fushen e ofrimit te shërbimeve te ndryshme online. Aktivitet kerkimor, perzgjedhje, orientim, trajnim dhe aktivitete profesionale trajnimi me sisteme ne largesi dhe multimediale. Te kryeje çdo transaksion lidhur me asetet e luajtshme ose pasurite e paluajtshme, vendosja e pengjeve, hipotekes, barreve si dhe aktivitete te cilat mund te konsiderohen te nevojshme per te arritur aktivitetin e Shoqerise.

3.2 Gjithashtu shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet ekonomik qe do te konsiderohet i nevojshem dhe i dobishem ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtarise, dhe qe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Kapitali fillestar dhe ndarja e tij

4.1 Kapitali i Shoqerise do te jete ne total 1 000 (njemije) Leke, 1 (nje) kuotë, me nje vlere nominale prej 1 000 (njemije) Leke.

4.2 Ortaku themelues Shoqerise dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri jane si meposhte:

(i) Ophelia Alice Elizabeth Braçe, lindur në Truro, Mbretëria e Bashkuar, më 26 dhjetor 1986, shtetase Angleze, banuese ne Shqipëri, me pasaport no. 146034687, me adrese:

Njësia Administrative Nr. 2, Rruga Ali Visha, Nd. 44, hyrja 2, Tiranë, e cila zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 1000 (një mijë) ALL e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 5

Transferimi i kapitalit

5.1 Aksionet transferohen sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 6

Organet drejtuese dhe Administrimi

6.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshte:

- a. Asambleja e Ortakeve
- b. Administratori

6.2 Kompetencat e Asamblese së Ortakeve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.

6.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë:

(i) Ophelia Alice Elizabeth Brace, lindur në Truro, Mbretëria e Bashkuar, më 26 dhjetor 1986, shtetase Angleze, banuese në Shqipëri, me pasaport no. 146034687, me adresë: Njësia Administrative Nr. 2, Rruga Ali Visha, Nd. 44, hyrja 2, Tiranë..

Neni 7

Gjuha

7.1 Ky Akt Themelimi hartohet në gjuhën shqipe dhe angleze nga 3 (tre) kopje secila.

7.2 Në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Akti Themelimi, versioni në gjuhën shqipe do të jetë mbizotërues dhe detyrues dhe i vetmi version me fuqi ligjore.

Neni 8

Te tjera

8.1 Cdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

8.2 Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i Shoqërisë, sot me datë 15/05/2024

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË

DEA GEORGIA IVY SHPK

Ophelia Alice Elizabeth Brace

